



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.921/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Elfete Mehmeti, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Elfete Mehmeti, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga radhët e subjektit NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, në Vendvotimet nr. 2503D/03R, 2522D/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 10.11.2017, nga Elfete Mehmeti, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit QV nr. 2503D/03R nga FRK kemi pasur 9 vota ndërsa nga RRP nga KQZ-ja numëri i votuesve është 0, duke i kërkuar PAP-it që të rishikohet ky rezultat. Më tutje ka theksuar se në QV nr. 2522D/01R kamë vota të familjarëve, mirëpo aty më figurojnë 6 vota.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve-FRK.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze. Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.A.nr.921/2017 me datë 12.11.2017

Kryesuese e Panelit
Zyndi Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.